

## K Ë R K E S Ë

### GJYKATËS SË RRETHIT TË FIERIT

Kërkuese: Mimoza Papingu, e bija e Mihalit dhe e Ndines, datëlindja 19.9.1965, banuese në lagjen “Kongresi i Përmetit”, Fier

Objekti: Shpalljen të zhdukur të shtetasit Aleksandër Papingu në bazë të neneve 15 e vijues të Kodit Civil dhe 375 e vijues të Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë.

Jam bashkëshortja e Aleksandër Sotir Papingut, me të cilin kam lindur dy fëmijë. Nga viti 1992 e më tej kam shkuar bashkë me të në emigracion ekonomik. Në korrik të vitit 1996, ndërsa unë qëndrova në Greqi, bashkëshorti im Aleksandri erdhi në Shqipëri, konkretisht në shtëpinë tonë në lagjen “Kongresi i Përmetit” në qytetin e Fierit. Nga ky muaj e deri më sot, unë dhe njerëzit tanë të afërm jo vetëm nuk e kemi parë Aleksandrin, por dhe nuk kemi asnjë lajm për të. Jam përpjekur dhe vetë nëpërmjet njerëzve tanë të afërt të hetojmë lidhur me të dhe rezultati ka qenë gjithnjë i njëjtë: Nuk di njeri të tregojë se ku ka vajtur dhe ku ndodhet. Meqenëse ka mbi dy vjet që nuk kemi lajm rreth tij, kërkoj që Aleksandër Papingu të shpallet i zhdukur.

KËRKUESJA  
**Mimoza Papingu**